

DREJTËSIA

DITARI MUJOR

KONFERENCA KOMBËTARE ANTIKORRUPSION MANJA: KEMI TRAJTUAR 493 DOSJE, 20 KALLËZIME PENALE PËR 40 ZYRTARË



Përgjatë tri ditëve është zhvilluar Konferenca e Parë Kombëtare Antikorrupsion. Mes shumë referuesve ka qenë i pranishëm edhe Ministri i Drejtësisë Z.Ulsi Manja ditën e parë, po ashtu edhe në ditën e përmbyllëse si pjestar i panelit final. Ndërkohë në ditën e dytë, ka qenë i pranishëm Drejtori i Përgjithshëm i Antikorrupsionit z.Gjergj Prabitaj. Në fjalën e tij Ministri i Drejtësisë ka bërë një përmbledhje të punës disa mujore të Drejtorisë Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë. Ai ka veçuar mes të tjerash trajtimin e 493 denoncimeve nga 1211 të ardhura, të cilat janë finalizuar në 20 kallzime penale për 40 zyrtarë të të gjitha niveleve në administratë. Po ashtu z.Manja ka bërë të ditur edhe për 79 masa administrative, 20 largime të menjëhershme nga puna, 7 heqje licencash më noterë e përmbarues etj. Në mbyllje të këtij aktiviteti, Ministri i Drejtësisë në fjalën e tij ka theksuar se arritjet e deritanishme kanë një bazë solide, i cili përbëhet nga vullneti politik në luftën ndaj korrupsionit, përkushtimi i të gjithë punonjësve për të arritur më të mirën në shërbim të publikut, dhe sidomos besimi i qytetarëve. [LINK 1](#) [LINK 2](#) [LINK 3](#)



MBLEDHJA E DY QEVERIVE MANJA-HAXHIU, FIRMOSET DEKLARATA E PËRBASHKËT

Nën moton “Të Përbashkuar” është zhvilluar në Prishtinë mbledhja e tetë mes qeverive shqiptare, asaj të Shqipërisë dhe Kosovës. Gjatë këtij takimi Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja është shprehur se mes dy ministrive respektive bashkëpunimi është konkret dhe i shkëlqyer. Ai ka përmendur miratimin nga të dy parlamentet të një marrëveshje në fushën tregtare dhe civile, ndërkohë që: “Me ministren Haxhiu jemi dakordësuar që bashkëpunimin në fushën e drejtësisë ta shtrijmë edhe më tej, drejt njohjes reciproke të licencave të avokatëve, të ndërmjetësve, por edhe në njohjen reciproke të provimit të jurisprudencës dhe ç’ka është më e rëndësishmja njohja dhe zbatimi i vendimeve që japin autoritetet tona gjyqësore në të dyja vendet. Do të ngremë një grup të përbashkët pune, grup i cili do të adresojë si duhet këto marrëveshje që do të firmosen, por edhe për të gjetur një mekanizëm ndershtetëror për të garantuar zbatimin e tyre”, ka thënë z.Manja në fjalën e tij. Më pas z.Ulsi Manja dhe znj. Albulena Haxhiut kanë firmosur një Deklaratë të Përbashkët. [LEXO PËR MË SHUMË](#)



MANJA TAKON KRYEPROKURORIN E ZVICRËS
Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja ka zhvilluar një takim të veçantë pune me kryeprokurorin e Zvicrës z.Stephan Blaettler. Ai shprehu mbështetjen e tij personale për SPAK, Prokurorinë e Përgjithshme, por edhe në kuadër të Eurojust .Ministri i Drejtësisë shprehu besimin e tij të plotë se me z.Blaettler në krye të Prokurorisë së Zvicrës, SPAK dhe Prokuroria shqiptare kanë një mbështetës dhe bashkëpunëtor ekselent në luftën kundër krimit të organizuar dhe pastrimit të parave. [LEXO PËR MË SHUMË](#)



PROMOVOHET REVISTA “REFLEKTIME”
Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka promovuar revistën “Reflektime”, me histori, dëshmi, e përjetime nga punonjës dhe të mitur në konflikt me ligjin në IEVP Kavajë. I pranishëm ka qenë edhe Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja, i cili është shprehur se: “Është një botë që duhet ta njohim, ta kuptojmë dhe të përpiqemi fort që asnjë tjetër fëmijë të mos e provojë, duke punuar me parandalimin e fenomeneve dhe shkaqeve që i çojnë fëmijët drejt gabimeve të rënda.” [LEXO PËR MË SHUMË](#)



MINISTRI I DREJTËSISË EMËRON DREJTORIN E RI NË POLICINË E BURGJEVE
Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja, pas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve z.Admir Abrija, ka emëruar në krye të Policisë së Burgjeve z. Paulin Rajta, Drejtues i Lartë, me një eksperiencë të gjatë në Policinë e Shtetit dhe në detyra të tjera të rëndësishme z.Rajta ka kryer studimet e larta në Akademinë e Policisë dhe në Drejtësi, si dhe ka një sërë trajnimesh profesionale në fusha të ndryshme, që nga lufta kundër terrorizmit deri në marrëdhëniet me publikun. [LEXO PËR MË SHUMË](#)



SKZHI 2021-2030, ZV/MINISTRJA E DREJTËSISË DREJTON TAKIMIN E PARË KONSULTATIV
U zhvillua takimi i parë konsultativ nën bashkëpunimin e ngushtë të partnerëve ndërkombëtarë, donatorë, institucionet bashkëpërgjegjëse, si dhe shoqërinë civile udhëhequr nga Zv/ Ministri i Drejtësisë Znj. Adea Pirdeni për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI 2021-2030), si dokumenti themelor strategjik që kombinon agjendën e integritetit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit për periudhën 10-vjeçare. [LEXO PËR MË SHUMË](#)

MANJA ME PËRKTHYESIT: RIPAMË TARIFAT, NË 1 SHTATOR PËRZGJEDHJET E REJA



Gjatë një takimi me përkthyesit zyrtarë, Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja ka vlerësuar punën e tyre si ura komunikimi njerëzore. Po ashtu ai ka vënë në dukje se ky profesion në nivelin e tij më të mirë, ndikon në cilësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar, por edhe rrit reputacionin e administratës publike dhe të shtetit shqiptar në komunikimin me Botën. Manja duke hyrë në thellë në problematikën e mbartur, ka thënë se me hyrjen në fuqi të ligjit të ri dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, janë riparë edhe tarifat e përkthimit zyrtar si dhe shpërndarja e drejtë e ngarkesës së punës. Ai njoftoi se në 1 Shtator 2022 do të bëhet edhe përzgjedhja e përkthyesve të rinj. [LEXO PËR MË SHUMË](#)

MANJA ME NDËRMJETËSIT E PASURIVETË PALUAJTSHME: JEMI KËTU SI GARANCIA JUAJ!



Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja ka zhvilluar një takim me ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme, pas hyrjes në fuqi të akteve nënligjore të ligjit që u miratua në fillim të këtij viti. “Me kuadrin e ri rregullator, këtij shërbimi për publikun, i shtohet dinjiteti me rregulla, procedura dhe garanci juridike në ushtrimin e tij. Deri më sot e keni ushtruar këtë profesion me risk e me kosto personale dhe të pambrojtur”, ka thënë në fjalën e tij z. Manja. Ai ka nënvizuar se miratimi i ligjit ishte përveçse një domosdoshmëri dhe kërkesë e kohës dhe politikave të shtetit shqiptar, por edhe një rekomandim nga FATF dhe Moneyval, si masë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. “Ne jemi këtu si garancia juaj”, është shprehur Ministri i Drejtësisë. [LEXO PËR MË SHUMË](#)

DËNIMET ALTERNATIVE, SHËRBIMI I PROVËS MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME MINISTRINË E TURIZMIT



Në prani të Ministrisë së Drejtësisë z.Ulsi Manja dhe Ministres së Turizmit dhe Mjedisit znj. Mirela Kumbaro, është nënshkruar në Ministrinë e Drejtësisë një Marrëveshje Bashkëpunimi mes Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe MTM. Marrëveshja synon zbatimin e vendimeve për personat nën mbikqyrje në konflikt me ligjin, me dënimin alternativ “Kryerja e një pune me interes publik”. Marrëveshje të tilla janë lidhur edhe me Bashkinë e Tiranës, apo bashki të tjera në vend. Sipas marrëveshjes së firmosur, MTM merr përsipër sigurimin e vendit të punës ku do të kryehet shlyerja e dënimit në dobi të komunitetit, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit dhe Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. [LEXO PËR MË SHUMË](#)